RAPORT VJETOR '03
ANNUAL REPORT



mbi tregun e sigurimeve ne shqiperi
on insurance market in albania

kms
komisioni i mbikëqyrjes së sigurimeve

Të dhënat financiare për vitin 2003, janë marre nga bilancet e shoqërive të sigurimeve.

Publikuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.
Rr. Perlat Rexhepi, Pall. 10 katesh, Tirane
Tel/Fax: +355 4 250 686
e-mail: kms@albaniaonline.net

Tregoni burimin e informacionit nëse perdorni të dhëna nga ky botim.

Grafika: Studio Grafike Elsi Kongo
Shtypi: PEGI

RAPORT VJETOR '**03**

mbi tregun e sigurimeve ne shqiperi

Republika e Shqiperise
Keshilli i Ministrave
Komisioni i Mbikeqyrjes se Sigurimeve

kms
komisioni i mbikëqyrjes së sigurimeve

Përmbajtja

I. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve 8

II. Legjislacioni në fushën e sigurimeve 11

III. Ekonomia shqiptare në vitin 2003 13

IV. Tregu i Sigurimeve 14

4.1 Primet 14

4.2 Ecuria vjetore e të ardhurave bruto nga primet 15

V. Ndarja e Tregut të Sigurimeve 16

5.1 Sigurimi i detyrueshëm e sigurimi vullnetar (jete, jo-jete) 16

5.2 Dëmet 17

5.3 Ndarja e tregut të sigurimeve sipas shoqërive të sigurimit 21

Tabela dhe Grafike

Tabela 1: Tregues te pergjithshem qe lidhen me tregun e sigurimeve
Tabela 2: Volumi i primeve bruto per vitet : 1999,2000,2001,2002,2003
Tabela 3: Volumi i primeve bruto ne vitet 2002,2003
Tabela 4: Volumi i primeve bruto ne vitin 2003, sigurimi i detyrueshem e sigurimi vullnetar (jete, jo-jete)
Tabela 5: Volumi i primeve bruto ne vitet : 1999, 2000,2001,2002,2003
Tabele 6: Deme te paguara ne vitin 2003
Tabele 7: Deme te paguara ne vite
Tabele 8: Ecuria e primeve dhe demeve ne vite , ne milione leke
Tabela 9: Demet e paguara nga shoqerite e sigurimit ne vitet : 2002,2003
Tabela 10: Demet e paguara nga shoqerite e sigurimit ne Sigurimin Motorrik
Tabela 11: Demet e paguara nga shoqerite e sigurimit ne Sigurimin e Pasurise
Tabela 12: Demet e paguara nga shoqerite e sigurimit ne Sigurimin e Shendetit
Tabele 13: Pjesmarja e shoqerive ne tregun e sigurimit per vitin 2003
Tabele 14: Pjesemarrja e shoqerive ne tregun e sigurimeve ne vite
Tabele 15: Volumi i primeve te Sigurimit te Detyrueshem te arketuara ne vite
Tabela 16: Volumi i primeve te Sigurimit Vullnetar te arketuara ne vite
Tabele 17: Struktura e primeve sipas portofoleve ne vite
Tabela 18: Volumi i primeve bruto te arketuara sipas klasave te Sigurimeve Motorrike gjate vitit 2003
Tabela 19: Volumi i primeve te Sigurimit te Detyrueshem TPL te arketuara ne vitet 2000, 2001, 2002, 2003
Tabela 20: Volumi i primeve te Sigurimit te Detyrueshem, Kartoni Jeshil, te arketuara ne vite
Tabela 21: Klasat e Sigurimit te Pasurise ne vitin 2003
Tabela 22: Klasat e Sigurimit te Aksidenteve dhe Shendetit ne vitin 2003
Tabela 23: Klasat e Sigurimit te Jetes ne vitin 2003
Tabela 24: Klasat e Sigurimit te Jetes ne vite
Tabela 25: Tregues te rentabilitetit per vitin 2003 , ne perqindje

5.4 Ndarja e tregut të sigurimeve sipas portofoleve të sigurimit 22
5.4.1 Sigurimet motorrike 23
5.4.2 Sigurimi i pasurisë 25
5.4.3 Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit 26
5.4.4 Sigurimi i jetes 27
5.5 Disa tregues të gjendjes së tregut të sigurimeve 28
5.6 Rezervat teknike dhe risigurimet 29
5.6.1 Rezervat teknike 29
5.6.2 Risigurimet 29

VI. Bilanci i shoqërive të sigurimit për vitin 2003 31
6.1 Aktivi 32
6.2 Pasivi 33
6.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, viti 2003 34

Shoqeritë e sigurimit në tregun Shqiptar 2003 35

Tabela 26: Treguesi i kufirit te fitimit per vitin 2003, ne perqindje
Tabela 27: Raporti deme / prime per vitin 2003, ne perqindje
Tabela 28: Treguesi fitimit per vitin 2003, ne perqindje
Tabela 29: Raporti i retensionit per vitin 2003
Tabela 30: Treguesi i kostos se marrjes ne sigurim per vitin 2003, ne perqindje
Tabela 31: Treguesi i shpenzimeve te pergjithshme per vitin 2003
Tabela 32: Treguesi i pozites paguese per vitin 2003, ne perqindje
Tabela 33: Rezervat teknike
Tabela 34: Prime te kaluara ne Risigurim gjate vitit 2003

Grafik 1: Ecuria e tregut te sigurimeve ne periudhen 1999-2003
Grafik 2: Ecuria e te ardhurave bruto te primeve gjate vitit 2003 e ndare sipas tremujoreve
Grafik 3: Tregu i sigurimeve gjate vitit 2003
Grafik 4: Shperndarja e demeve gjate vitit 2003
Grafik 5: Ecuria e primeve dhe demeve ne vite, ne milione leke
Grafik 6: Demet e paguara nga shoqerite e sigurimit ne vitet : 2002,2003
Grafik 7: Demet e paguara ne sigurimin motorrik nga shoqerite e sigurimit gjate viteve 2002, 2003
Grafik 8: Demet e paguara nga shoqerite e sigurimit ne Sigurimin e Pasurise gjate viteve 2002, 2003
Grafik 9: Demet e paguara nga shoqerite e sigurimit ne Sigurimin e Shendetit gjate viteve 2002, 2003
Grafik 10: Ecuria e te ardhurave bruto te primeve sipas shoqerive te sigurimit ne vite
Grafik 11: Raporti i Sigurimit Vullnetar dhe Sigurimit te Detyrueshem ne shoqerite e sigurimit
Grafik 12: Ndarja e tregut te sigurimit motorrik sipas portofoleve
Grafik 13: Ndarja e Tregut te Sigurimit te Pasurise sipas portofoleve ne vitin 2003
Grafik 14: Ndarja e tregut te sigurimit te aksidenteve dhe shendetit sipas portofoleve ne vitin 2003
Grafik 15: Ndarja sipas klasave te Sigurimit te Jetes

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve

Gëzim Agasi
Kryetar

Teuta Cani
Nënkryetare

Silvana Bello
Nënkryetare

Hysen Çela
Anëtar

Shpëtim Shehu
Anëtar

Genc Çifligu
Anëtar

Adriatik Islamaj
Anëtar

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve në vijim të përmirësimit të vazhdueshëm të metodave te kontrollit dhe mbikëqyrjes, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve , rritjen e transparencës në ndihmë të zhvillimit të industrisë së sigurimeve në Shqipëri, publikon Raportin Vjetor të vitit 2003.

Ky raport jep një permbledhje të treguesve të tregut të sigurimeve në Shqipëri, duke dhënë një panoramë të tij dhe ndikimit të këtij tregu në zhvillimin e ekonomisë, duke shpresuar të jetë një publikim i nevojshëm dhe praktik.

Megjithëse treguesit e tregut të sigurimeve per vitin 2003 janë modestë, ato flasin qartë per një treg në konsolidim, drejt perafrimit me eksperiencat europiane.

Do të ishin në interesin tonë të përbashkët dhe veçanërisht të dobishme opinionet dhe vleresimet kritike për këtë raport, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të metodave të punës të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve, për t'i dhene drejtimin e nevojshëm tregut te sigurimeve në Shqipëri.

Gëzim Agasi

Kryetar

1. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve është autoriteti i vetem ligjor që licenson, kontrollon dhe mbikëqyr shoqeritë e sigurimit në mbrojtje të interesave të të siguruarve. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin 8081, date 07.03.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe/ose risigurimit" dhe VKM Nr 229, dt 28.04.1999 "Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të KMS". Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve përbëhet nga Komisioni dhe Stafi Ekzektuiv.

KOMISIONI përbehet nga Kryetari, dy nënkryetarë dhe 4 anëtarë.
Kryetari i KMS emërohet nga Keshilli i Ministrave me propozim te Ministrit të Financave, ndërsa nënkryetarët dhe katër anëtarët emerohen nga ministri i Financave me propozim te kryetarit te KMS-se. Komisioni është organ kolegjial dhe në permbushje të funksioneve të tij nxjerr vendime, udhëzime dhe rregullore.

Stafi ekzekutiv i KMS

STAFI EKZEKUTIV i Komisionit të Mbikeqyrjes së Sigurimeve ushtron veprimtarinë e tij me qellim realizimin e detyrave që dalin ne zbatim të ligjeve, urdhrave dhe akteve nënligjore në fuqi si dhe siguron zbatimin e tyre me përpikmëri nga ana e shoqërive të sigurimit dhe aktorëve të tjerë në tregun e sigurimeve.

Veprimtaria e ketij institucioni, gjatë vitit 2003, u orientua në drejtimet e mëposhtme:

- Mbikëqyrje dhe kontroll i shoqërive të sigurimit, vendimmarrje, nisma legjislative, çështje administrative.

Duke iu referuar ndryshimeve qe po kalon ekonomia shqiptare ne përgjithësi dhe tregu i sigurimeve ne veçanti, vlen te theksojme disa specifika te këtij tregu gjate vitit 2003 që tregojnë qartë ecurine drejt modernizimit të industrisë së sigurimeve në Shqipëri.

Në vijim të këtyre ndryshimeve, duke e parë si nevoje të tregut si dhe bazuar në sygjerimet dhe asistencën e Bankës Boterore, Qeveria Shqiptare nëpermjet Ministrisë së Financave dhe Komisionit të Mbikeqyrjes së Sigurimeve ndërmori nismën për hartimin e projektligjit "Mbi veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetesimit", i cili mbeshtetet tërësisht në praktikën e vendeve europiane.

Ky draft ofron përkufizime mbi veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve në përputhje me direktivat e BE dhe parimet baze te IAIS të cilat do të mundësojnë stabilizimin dhe zhvillimin e mëtejshem të tregut shqiptar të sigurimeve si një treg i stabilizuar, efiçent dhe transparent.

Gjithashtu, me rritjen e tregut bëhet më se i domosdoshëm licensimi i shoqërive të ndermjetësimit, ky ligj jep kushtet dhe rregullat për licensimin e tyre.
Po ashtu, në këtë ligj një vëmendje e vecante i është kushtuar mbrojtjes së policëmbajtësve dhe aprovimi i ketij ligji sigurisht do të lehtesonte aktivitetin e tregut të sigurimeve në të ardhmen.

Projektligji mbi veprimtarinë e Komisionit te Mbikëqyrjes së Sigurimeve është hartuar duke marrë për bazë eksperiencën eurpiane në këtë drejtim si dhe parimet e IAIS, te cilat, për vete stadin e zhvillim të tregut do te mund t'i japin Komisionit , autoritetin e vërtetë te rregullatorit, mbrojtësit te interesave te policëmbajtesve dhe inisiatorit për zhvillimin e këtij tregu, gjithmonë në ngritje të vazhdueshme profesionale.

Gjithashtu nëpermjet këtij projektligji synohet të rritet transparenca gjatë procesit të licensimit të shoqërive të sigurimit si dhe të vendosen rregulla strikte me qëllim mbikëqyrjen e aktivitetit të tyre.

Tregu shqiptar i sigurimeve gjatë vitit 2003 pësoi ndryshime rrënjesore për sa i përket edhe infrastuktures së tij.

Për herë të parë rrjeti i shitjes së shoqerive të sigurimit operon nëpërmjet agjentëve të licensuar nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve.

Rreth 560 agjentë që kanë dhenë testimin profesional dhe plotesojne kushtet e kërkuara, operojnë tashmë në gjithë vendin.

Vlen të theksojmë se e një rëndësie të veçantë është dhe hyrja në tregun shqiptar të sigurimeve, për herë të parë në vitin 2003, e institucioneve ndërkombetare financiare. Tashme partnerë të shoqërive shqiptare të sigurimit janë institucione të rëndësishme financiare:
BERZH dhe IFC jane partneret e rinj të INSIG-ut duke zotëruar 39%, ndersa FSHAN-ja(Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve) është partner i shoqërisë SIGAL me 12%. Këto ndryshime rrënjësore tregojnë edhe një herë evoluimin e tregut shqiptar të sigurimeve drejt stabilitetit dhe zhvillimit.

Gjithashtu gjatë vitit 2003 Komisioni i Mbikëqyrjes se Sigurimeve ka ndërmarrë nisma për hartimin rregulloreve:

- Mbi licensimin e brokerave në sigurimeve, një proces ky i domosdoshem për vetë stadin ne te cilin ndodhet tregu shqiptar i sigurimeve.
- Mbi parandalimin e pastrimit të parave në aktivitetin e sigurimeve
- Mbi Standardet e Kontrollit
- Mbi Sistemin e Raportimit

Në Qershor të vitit 2003, në bashkëpunim me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë, Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve organizoi Konferencën e Parë Rajonale "Sigurimet - pjesë integrale e tregut financiar dhe faktor në zhvillimin e ekonomisë" në të cilën morën pjesë aktorë të rëndësishëm të tregut të sigurimeve nga Rajoni dhe Europa.

Konferenca Rajonale, Qershor 2003

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve gjatë ketij viti ka marrë inisiativa për organizimin e seminareve të ndryshme me qëllim ngritjen e nivelit teknik të stafit të tij apo edhe të shoqërive të sigurimit, siç ishte edhe Seminari Aktuarial i organizuar në Tiranë me pjesëmarrjen e Kompanive të sigurimit jo vetem nga Shqipëria por edhe nga Kosova.

Seminar aktuarial, Dhjetor 2003

Në kuadër të koordinimit sa më të mirë të punës ndermjet instancave shtetërore të ngarkuara me ligj për kontrollin dhe mbikeqyrjen e aktiviteteve të subjekteve private, KMS gjatë vitit 2003 ndërmori nisma për të hartuar, negociuar dhe nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacionesh respektive me disa institucione të lidhura me sektorin e sigurimeve, dhe konkretisht KMS ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi me:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve
- Ministrinë e Transporteve (DPSHTR)

Gjatë vitit 2004 kanë filluar procedura për nënshkrimin e marrëveshjeve me Ministrine e Rendit (Drejtorine e Pergjithshme te Policise), në kuadrin e kontrollit te zbatimit te legjislacionit të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, me Bankën e Shqipërise në kuadrin e bashkërendimit të punës për kontrollin e sistemit financiarë-bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrese të sigurimeve në rajon ndërsa gjatë vitit 2004 do të nënshkruhet memorandumi i mirëkuptimit me Autoritetin Mbikeqyres te Kosovës si dhe do të fillojnë negociatat për nënshkrimin e tij me Autoritetet Mbikëqyrese të Sigurimeve të Italisë, Greqisë, Maqedonisë. Ky dokument do të hedhë formalisht bazat e bashkëpunimit ndëinsitucional me këto autoritete, me qëllim rritjen dhe përmirësimin e metodave mbikëqyrese, përafrimin e tyre me standardet europiane si dhe zhvillimin e mëtejshem të industrisë së sigurimeve.

Marrëdheniet me institucionet ndërkombëtare

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve është anëtar me të drejta të plota në Shoqatën Ndërkombëtare të Autoriteteve Mbikëqyrese të Sigurimeve (IAIS). Anëtarësimi i KMS në këtë organizëm i ka dhënë mundësinë stafit të Komisionit të marrë pjesë në aktivitete trajnuese dhe konferenca ndërkombëtare të organizuara nga IAIS dhe organizata të tjera gjate vitit 2003. Pjesëmarrja në këto aktivitete është vlerësuar si tepër e frytshme në funksion të përmirësimit të standardeve të mbikeqyrjes dhe njohjes me të rejat në këtë fushë.

Gjithashtu gjate vitit 2003 Komisioni ka ndërrmarë inisiativen e fillimit të

2. Legjislacioni në fushën e sigurimeve

Veprimtaria e sigurimeve dhe risigurimeve në Shqipëri bazohet dhe rregullohet nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore të mëposhtme:

- Kushtetuta e Republikes se Shqiperise
- Kodi Civil datë 1.11.1994.
- Ligji 8081, datë 7.03.2001 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe/ose risigurimit" (i ndyrshuar), me anë të të cilit përcaktohen parimet dhe rregullat e përgjithshme lidhur me veprimtaritë e sigurimit dhe/ose risigurimit si dhe me mbikeqyrjen nga ana e shtetit të shoqërive dhe enteve ligjore që marrin përsipër e ushtrojnë veprimtari sigurimi dhe ose risigurimi
- Ligji Nr 7641, datë 1.12.1992 "Për miratimin me ndryshime të Dekretit Nr 295, datë 15.09.1992 "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë."
- VKM Nr 626, datë 8.10.1998 "Për kufijtë minimalë të Fondit të garancisë të shoqërive të sigurimeve dhe/ose risigurimeve"
- VKM Nr. 229, datë 28.04.1999 "Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të KMS"
- VKM Nr.470,date 03.10.2002 "Mbi kushtet e dhenies se autorizimit zyrtar dhe rregullat e ndërmjetësimit ne sigurime"
- Udhëzime dhe Urdhra të Ministrit të Financave.
- Rregullore të KMS

Kuadri ligjor i mësipërm lejon:

- Krijimin e shoqërive private të sigurimit.
- Veprimtaria e sigurimeve dhe ose risigurimeve ushtrohet nga shoqëri të themeluara në formën e shoqërive anonime me kapital vendas ose te huaj , ndërsa shoqëria e huaj e sigurimit ose risigurimit mund të ushtrojë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë vetëm nëpërmjet degës së saj të vendosur në këtë territor.
- Një shoqëri sigurimi nuk mund të ushtrojë në të njëjtën kohë veprimtari sigurimi për jetën dhe jo-jeten.
- Shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit duhet të kenë një kapital themeltar, pa përfshirë kontributet në natyrë, qe varion nga 50-100 milion lekë, në varësi të grupeve të sigurimit që shoqëria do të ushtrojë në sigurimin e dëmeve, dhe jo më të vogël se 120 milion lekë nëse shoqëria do të ushtrojë veprimtari në sigurimin e jetës.
- Shoqëritë që do të ushtrojnë veprimtari sigurimi dhe/ose risigurimi do të nisin veprimtarinë e tyre vetëm pasi të kenë marrë autorizim zyrtar nga Komisioni i Mbikeqyrjes së Sigurimeve.
- Një shoqëri sigurimi vendase ose degë e shoqerise se huaj mund të pajiset me autorizim zyrtar nga Komisioni i Mbikeqyrjes së Sigurimeve ne qofte se përmbush kushte të tilla si:
  - Të jetë themeluar në formën e përcaktuar nga Ligji 8081, datë 7.03.1996
  - Të ketë një program veprimtarie të hartuar sipas kërkesave të Ligjit 8081, datë 7.03.1996
  - Të zotërojë kufijtë minimalë të fondit të garancisë
  - Drejtimi efektiv i shoqërisë t'u jetë besuar personave fizikë me kualfikim e përvojë profesionale të mjaftueshme.

- Shoqëritë e autorizuara për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe ose risigurimi në Republikën e Shqiperisë mbikëqyren nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, me qëllim mbrojtjen e interesave të të siguruarve.
- Shoqëritë e sigurimit që kryejnë sigurime motorrike krijojnë Byronë Motorike që i përfaqëson këto shoqëri në tregun vendas dhe të huaj.
- Pjesëmarrja e kapitalit të huaj në një shoqëri sigurimi vendase është e pakufizuar.
- Shoqeritë e huaja të sigurimit dhe/ose risigurimit të cilat kërkojnë të ushtrojnë veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet degëve të tyre duhet të kenë një eksperiencë në fushën e sigurimeve të paktën prej 5 vjetësh në shtetin e origjinës.
- Kufijtë minimale të fondit të garancisë të një shoqërie sigurimi dhe/ose risigurimi variojnë nga 30 – 60 milionë lekë në fillim të veprimtarisë dhe 50 – 90 milionë lekë në fund të vitit të dytë financiar të veprimtarisë, në varësi të grupeve të sigurimit që shoqëria do të ushtrojë në sigurimin e dëmeve; nëse shoqëria do të ushtrojë veprimtari në sigurimin e jetës, 120 milione lekë në fillim të veprimtarisë dhe 180 milionë lekë në fund të vitit të dytë financiar
- Tarifat e primeve të sigurimit vullnetar caktohen nga vetë shoqëria e sigurimit, tarifat e primeve të sigurimit të detyrueshëm caktohen nga Ministri i Financave.
- Sigurimi i detyrueshëm përfshin klasën e përgjegjësive civile nga përdorimi i automjeteve, pra kontratën e sigurimit të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj paleve të treta brenda territorit të vendit (TPL); kontratën e sigurimit të mbajtësit të mjetit motorik që vihet në qarkullim me targë të përkohshme; kontratën e sigurimit të mbajtësit të mjetit motorrik për përgjegjësitë jashtë territorit të vendit (kartoni jeshil); kontratën e sigurimit të mbajtësit të mjetit motorik me targë regjistrimi të huaj por që e ka lidhur me një sigurues vendas (kontratën e sigurimit kufitar).
- Të gjitha kontratat e sigurimit (dëme dhe jetë) janë subjekt i TVSH prej 20%.

3. Ekonomia shqiptare ne vitin 2003

Rritja ekonomike ne Shqipëri per vitin 2003, rezultoi në masën 6 për qind në krahasim me 4.7 për qind regjistruar në 2002. Rritje e aktivitetit ekonomik vihet re në të gjithë sektorët e ekonomisë por vecanërisht në sektorin e ndërtimit, të transportit dhe të shërbimeve. Në këtë rritje kanë dhënë kontributin e tyre edhe rritja e investimeve duke arritur vleren e 22.3 për qind te PBB. Investimet në sektorin privat që përbëjnë rreth 75% të totalit të investimeve gjatë vitit 2003 gjetën një mbështetje të madhe edhe nga sektori bankar.

Viti 2003 ka regjistruar një përmirësim të lehtë në situatën e punësimit. Numri i të punësuarve ka pësuar rritje ndërkohë që faktorët kronikë të tranzicionit shqiptar: emigrimi dhe informaliteti i ekonomisë ndikojnë në uljen e forcave të punës gjithsej dhe vështirësojnë shpjegimin e efektit në punësim të politikave dhe zhvillimeve ekonomike të vendit. Në fund të vitit 2003, shkalla e papunësisë u ndal në nivelin 15 për qind, krahasuar me 15.8 për qind që ishte në fund të vitit 2002.

Viti 2003 u karakterizua nga një inflacion i ulët, brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Vlera e inflacionit në muajin dhjetor ishte 3.3 për qind, duke respektuar objektivin e Bankës së Shqipërisë ndërkohë që mesatarisht, gjatë vitit 2003, çmimet e konsumit janë rritur me 2.37 për qind.

Pavarësisht faktorëve të ndryshëm që kanë ndikuar, vlerësohet se ky inflacion i ulët ka reflektuar kontrollin e presioneve të kërkesës së brendshme si pasojë e politikave të shëndosha fiskale e monetare.

Ndryshe nga vitet e tjera, ky vit që sapo lamë u karakterizua nga një shpërndarje më racionale e shpenzimeve fiskale. Shpërndarja e kërkesave të qeverisë për huamarrje ka qenë më e njëtrajtshme gjatë vitit 2003, duke shmangur përqendrimin e financimit të deficitit në muajin dhjetor. Gjithashtu, zgjedhjet lokale të tetorit dhe klima e acaruar politike gjatë gjysmës së dytë të vitit nuk janë shoqëruar me përqendrime të shpenzimeve buxhetore apo me kompromet im të disiplinës fiskale. Së bashku me kufizimin e huamarrjes së brendshme të qeverisë në nivelin 2.7 për qind të PBB-së, kanë përbërë një kontribut të çmuar të politikës fiskale për stabilitetin makroekonomik në përgjithësi, dhe për atë të çmimeve në veçanti. Megjithatë, duhet theksuar se pika të dobëta mbeten realizimi i të ardhurave në masën 93 për qind dhe veçanërisht realizimi i shpenzimeve kapitale në masën 62 për qind të planit.

Viti 2003 është karakterizuar nga një aktivitet intensiv në sektorin e jashtëm të vendit, i shprehur në rritjen e konsiderueshme të të ardhurave dhe të shpenzimeve korente. Deficiti i llogarisë korente vlerësohet të ketë arritur në 6.7 për qind të PBB-së, duke u ulur me 2 pikë përqindjeje krahasuar me një vit më parë. Duhet theksuar se deficiti tregtar në terma absolutë vazhdon të thellohet. Ai reflekton kryesisht rritjen e konsumit të ekonomisë shqiptare dhe nënvizon nevojën e rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe konkurruese të ekonomisë shqiptare. Pavarësisht sa më sipër, pozicioni i përgjithshëm i bilancit të pagesave është pozitiv, duke bërë që rezervat valutore të vendit të rriten vazhdimisht. Për herë të parë, në muajin dhjetor, niveli i përgjithshëm i tyre kaloi shifrën 1 miliard dollarë amerikanë, për të regjistruar më saktësisht 1.026 miliardë dollarë në fund të muajit Dhjetor 2003.

Burimi i Informacionit:
Banka e Shqiperisë, Raporti Vjetor 2003

4. Tregu i sigurimeve

Që nga viti 1999 që daton liberalizimin e tregut të sigurimeve në Shqipëri, ky treg ka njohur ritme zhvillimi në të ardhurat bruto të primeve.

Tabela 1: Tregues te pergjithshem qe lidhen me tregun e sigurimeve;

Treguesit	1999	2000	2001	2002	2003
Prodhimi i Brendshem Bruto (PBB)					
PBB çmime korente ne mln leke	488,611	551,282	590,237	658,062	744,974
PBB çmime korente ne mln usd	3,548	3,836	4,114	4,696	6,027
PBB (ne usd per fryme)	1,052	1,128	1,333	1,521	1,934
Prime te arketuara (ne mln leke)	1,847	2,017	2,967	3,804	3,755
Raporti i primeve te arketuara ndaj PBB (ne %)	0.38	0.37	0.50	0.58	0.50
Popullsia (ne mije banore)	3,283	3,401	3,069	3,069	3,069
Primi per fryme (ne leke)	562	593	966	1,239	1.224
Primi per fryme (ne usd)	4.20	4.10	6.70	8.84	11.48
Deme te paguara (ne mln leke)	783	710	736	859	1,306
Numri i shoqerive te sigurimit	3	3	5	5	5
Numri i punonjesve ne shoqerite e sigurimit	687	458	574	637	613

4.1 Primet

Volumi i primeve, për vitin 2003 u ul me 1.28 për qind, krahasuar me një vit më parë. Në kater vitet e mëparshme ky aktivitet është vlerësuar me rritje, ndërkohë që në vitin e pestë pësoi një ulje të lehtë

Tabela 2: Volumi i primeve bruto per vitet : 1999,2000,2001,2002,2003.

Vitet	1999	2000	2001	2002	2003
Primet	1,847	2,017	2,967	3,804	3,755
Tendenca e rritjes		**9.20%**	**40.10%**	**28.20%**	**-1.28%**

Grafik 1: Ecuria e tregut të sigurimeve në periudhën 1999-2003



4.2 Ecuria vjetore e të ardhurave bruto nga primet

Fillimi i vitit 2003 dha sinjale pozitive të cilat u ndjenë deri në muajin gusht por ngadalë simi i theksuar në katërmujorin e fundit çoi në uljen e të ardhurave në këtë sektor të tregut financiar.

Rënia e volumit të primeve për vitin 2003 krahasuar me një vit më parë ndjehet në sigurimin vullnetar Jo-Jetë me 4.75 për qind ;

- Në sigurimin vullnetar Jo-Jetë peshën më të madhe në të ardhurat nga primet e zë Portofoli i sigurimit nga Zjarri dhe Forcat e Natyres, ku vihet re se primi mesatar në vitin 2003 ka ulje afërsisht 21 % në krahasim me vitin 2002 ;

Grafik 2: Ecuria e të ardhurave bruto të primeve gjatë vitit 2003 e ndarë sipas tremujorëve



Tabela 3: Volumi i primeve bruto në vitet 2002,2003;

Lloji i Sigurimit	2002	2003
1) Sigurime te detyrueshme	2,675.09	2,865.33
2) Sigurime vullnetare	1,128.65	889.75
Nga keto		
a) Sigurimi i Jetes	285.00	86.12
b) Sigurimi i jo-jetes	843.65	803.63
Gjithsej	**3,803.74**	**3,755.09**

5. Ndarja e Tregut të Sigurimeve

5.1 Sigurimi i detyrueshëm e sigurimi vullnetar (jetë – jo-jetë)

Në vitin 2003 volumi i primeve bruto të arkëtuara rezultoi 3,755.09 mlionë lekë , kundrejt 3,803.74 milionë lekë të arkë tuar në vitin 2002, ose 1.28% më të ulëta se nje vit më parë.
Tregu i sigurimeve edhe në vitin 2003 u orientua drejt sigurimit të detyrueshme. Volumi i primeve bruto të arkëtuara nga portofolet e Sigurimeve të detyrueshëm në vitin 2003 rezultoi 7.12 për qind më i lartë se ai i vitit 2002, duke zënë një pozicion me rreth 76.31 për qind të totalit të primeve të arkëtuara në vitin 2003.

Volumi i primeve bruto të arkëtuara nga portofolet e Sigurimeve vullnetare rezultoi 21.17 për qind më i ulet se ai vitit 2002, duke zënë një pozicion me rreth 23.69 për qind të totalit të primeve të arkëtuara në vitin 2003. Në vitin 2003 tregu shqiptar i sigurimeve vullnetare mbeti i orientuar drejt sigurimeve të jo – jetës. Volumi i primeve të arkëtuara nga portofolet e sigurimit të jo – jetes në vitin 2003, rezultoi 90.32 për qind të totalit të primeve bruto të arkëtuara , ndërkohë që volumi i primeve bruto të arkëtuara nga portofolet e sigurimit të Jetës rezultoi në masën 9.68 për qind të totalit të primeve bruto të arkëtuara.

Tabela 4: Volumi i primeve bruto në vitin 2003, sigurimi i detyrueshëm e sigurimi vullnetar (jetë, jo – jetë)

Lloji i sigurimit	Numri i kontratave	Primet	
		(mln leke)	(mije USD)
A) Sigurime te detyrueshme	282,336	2,865.33	26,884.35
B) Sigurime vullnetare	114,891	889.75	8,348.23
Nga keto			
a) Sigurimi i jetes	21,385	86.12	808.03
b) Sigurimi i jo-jetes	93,506	803.63	7,540.20
Gjithsej	**397,227**	**3,755.09**	**35,232.58**

Grafik 3: Tregu i sigurimeve gjatë vitit 2003



Tabela 5: Volumi i primeve bruto në vitet: 1999, 2000,2001,2002,2003.

Lloji i sigurimit	1999	2000	2001	2002	2003
A) Sigurime te detyrueshme	1,564.00	1,545.00	2,078.50	2,675.09	2,865.33
B) Sigurime vullnetare	283.00	472.00	888.50	1,128.65	889.75
Nga keto					
a) Sigurimi i jetes	4.00	8.50	175.00	285.00	86.12
b) sigurimi i jo-jetes	279.00	463.50	713.50	843.65	803.63
Gjithsej	**1,847.00**	**2,017.00**	**2,967.00**	**3,803.74**	**3,755.09**

5.2 Dëmet

Në vitin 2003 dëmet e paguara rezultuan 1,306 milionë leke ose 448 milionë lekë me shumë se në vitin 2002.
Vlera më e madhe e dëmeve të paguara i përket Sigurimit të detyrueshëm të cilat zënë 83.84 për qind të totalit të tyre.
Dëmet e paguara ne portofolet e sigurimit vullnetar rezultuan 211 milionë lekë që përbëjnë 16.16 për qind të totalit të dëmeve të paguara. Përsa i përket ndarjes midis dy aktiviteteve siguruese Dëme (jo-jete) dhe Jete, dëmet e paguara në vitin 2003 i përkasin 84.07 për qind sigurimit te Dëmeve (jo-jete)).

Tabele 6: Dëme të paguara në vitin 2003.

Lloji i sigurimit	Demet	
	(mln leke)	(mije USD)
1) Sigurime te detyrueshme	1,095.65	10,280.11
2) Sigurime vullnetare	211.20	1,982.00
Nga keto		
a) Sigurimi i jetes	33.65	315.75
b) Sigurimi i jo-jetes	177.55	1,666.00
Gjithsej	**1,306.85**	**12,261.71**

Tabele 7: Dëme të paguara në vite.

Lloji i sigurimit	1999	2000	2001	2002	2003
1) Sigurime te detyrueshme	714.85	632.30	635.00	711.38	1,095.65
2) Sigurime vullnetare	68.59	78.00	101.00	147.24	211.20
Nga keto					
a) Sigurimi i jetes	0.40	0.30	0.50	12.75	33.65
b) Sigurimi i jo-jetes	68.19	77.70	100.50	134.49	177.55
Gjithsej	**783.44**	**710.30**	**736.00**	**858.62**	**1,306.85**

Grafik 4: Shpërndarja e dëmeve gjatë vitit 2003.



Tabele 8: Ecuria e primeve dhe dëmeve në vite, në milionë lekë.

Vitet	Prime te Arketuara	Deme te Paguara
1997	1,211.00	559.00
1998	1,537.00	752.00
1999	1,847.00	783.00
2000	2,017.00	710.00
2001	2,967.00	736.00
2002	3,803.74	858.62
2003	3,755.09	1,306.85

Grafik 5: Ecuria e primeve dhe dëmeve në vite , në milionë lekë;



Dëmet e paguara nga shoqëritë e sigurimit në vitin 2003 evidentohen në vlerën 1,306.86 milionë lekë. Ndarja e dëmeve të paguara sipas shoqërive të sigurimit për vitin 2003 pasqyron rritjen e ketyre vlerave të paguara nga shoqeritë Insig, Sigma, Sigal, Intersig dhe në menyrë me pak të ndjeshme nga shoqëria Atlantik.

Tabela 9: Dëmet e paguara nga shoqëritë e sigurimit në vitet: 2002, 2003.

Shoqerite	2003		2002	
	Demet mln	%	Demet mln	%
INSIG	685.94	52.49%	518.08	60.34%
SIGMA	236.21	18.07%	152.89	17.81%
SIGAL	288.91	22.11%	152.51	17.76%
ATLANTIK	29.45	2.25%	13.86	1.61%
INTERSIG	66.35	5.08%	21.28	2.48%
Gjithsej	**1,306.86**	**100.00%**	**858.62**	**100.00%**

Grafik 6: Dëmet e paguara nga shoqëritë e sigurimit në vitet: 2002, 2003.



Tabela 10: Dëmët e paguara nga shoqëritë e sigurimit në Sigurimin Motorrik.

Shoqerite	2002		2003	
	Demet mln	%	Demet mln	%
INSIG	478.32	60.92%	631.05	52.73%
SIGMA	136.57	17.39%	200.56	16.76%
SIGAL	135.35	17.24%	271.82	22.71%
ATLANTIK	13.61	1.73%	29.24	2.44%
INTERSIG	21.28	2.71%	64.07	5.35%
Gjithsej	**785.13**	**100.00%**	**1,196.74**	**100.00%**

Grafik 7: Dëmet e paguara në Sigurimin Motorrik nga shoqërite e sigurimit gjatë viteve 2002, 2003.



Tabela 11: Dëmet e paguara nga shoqeritë e sigurimit në Sigurimin e Pasurisë.

Shoqerite	2002		2003	
	Demet mln	%	Demet mln	%
INSIG	9.96	31.37%	16.07	27.67%
SIGMA	12.95	40.79%	34.08	58.69%
SIGAL	8.76	27.59%	7.92	13.64%
ATLANTIK	0.08	0.25%	0	0.00%
INTERSIG	0	0.00%	0	0.00%
Gjithsej	**31.75**	**100.00%**	**58.07**	**100.00%**

Grafik 8: Dëmet e paguara nga shoqeritë e sigurimit në Sigurimin e Pasurisë gjate viteve 2002, 2003.



Tabela 12: Dëmet e paguara nga shoqeritë e sigurimit në Sigurimin e Shëndetit.

Shoqerite	2002		2003	
	Demet mln	%	Demet mln	%
INSIG	17.05	58.81%	5.17	28.11%
SIGMA	3.37	11.62%	1.57	8.54%
SIGAL	8.4	28.98%	9.17	49.86%
ATLANTIK	0.17	0.59%	0.2	1.09%
INTERSIG	0	0.00%	2.28	12.40%
Gjithsej	**28.99**	**100.00%**	**18.39**	**100.00%**

Grafik 9: Dëmet e paguara nga shoqeritë e sigurimit në Sigurimin e Shëndetit gjatë viteve 2002, 2003.



5.3 Ndarja e tregut te sigurimeve sipas shoqerive te sigurimit

Edhe gjatë vitit 2003 tregu Shqiptar i sigurimeve u nda ndërmjet pesë shoqërive të sigurimeve : Insig, Sigma, Sigal, Atlantik, Intersig.
Në këtë industri kapitali vendas është mbizotërues, ndërsa kapitali i huaj perfaqesohet me pjesëmarrje 39 % në shoqërine Insig dhe 12 % ne shoqërine Sigal. Në vitin 2003 në tregun e sigurimit dominojnë tri shoqëritë Sigal, Sigma, Insig, megjithëse edhe dy shoqëritë e tjera kanë një rritje

Tabelë 13: Pjesëmarja e shoqërive në tregun e sigurimit për vitin 2003.

Shoqerite	Prime te arketuara	Pesha specifike
	(mln leke)	(mln leke)
INSIG	935.02	24.90%
SIGMA	1,059.93	28.23%
SIGAL	1,100.52	29.31%
ATLANTIK	307.97	8.20%
INTERSIG	351.66	9.36%
Gjithsej	**3,755.09**	**100.00%**

Tabelë 14: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimeve në vite.

Shoqerite	1999		2000		2001		2002		2003	
	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%
INSIG	1,,709	93	1,427	70.8	1,727	58.3	1,430.24	37.6	935.02	24.90
SIGMA	108	5.9	302	14.9	523	17.6	892.3	23.46	1,059.93	28.23
SIGAL	30	1.6	288	14.3	647	21.8	1,051.84	27.65	1,100.52	29.31
ATLANTIK	0	0	0	0	60	2	228.83	6.02	307.96	8.20
INTERSIG	0	0	0	0	10	0.3	200.53	5.27	351.66	9.36
Gjithsej	**1,847**	**100**	**2,017**	**100**	**2,967**	**100**	**3,803.74**	**100**	**3,755.09**	**100**

Grafik 10: Ecuria e të ardhurave bruto të primeve sipas shoqërive të sigurimit në vite.



Tabele 15: Volumi i primeve të Sigurimit të Detyrueshëm të arketuara në vite.

Shoqerite	1999		2000		2001		2002		2003	
	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%
INSIG	1,449.0	92.7	1,071.0	69.3	1,163.0	55.9	767.50	28.69	558.31	19.48
SIGMA	96.0	6.1	290.0	18.8	475.0	22.9	810.59	30.30	949.97	33.15
SIGAL	19.0	1.2	184.0	11.9	374.0	18.0	714.04	26.69	765.13	26.70
ATLANTIK	-	-	-	-	57.5	2.8	191.27	7.15	272.63	9.51
INTERSIG	-	-	-	-	9.0	0.4	191.69	7.17	319.30	11.14
Gjithsej	**1,564.0**	**100.0**	**1,545.0**	**100.0**	**2,078.5**	**100.0**	**2,675.09**	**100.00**	**2,865.33**	**100.00**

Tabela 16: Volumi i primeve të Sigurimit Vullnetar të arkëtuara në vite (milion lekë).

Shoqerite	1999		2000		2001		2002		2003	
	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%
INSIG	260.0	91.9	356.0	75.4	564.0	63.5	662.74	58.72	376.71	42.34
SIGMA	12.0	4.2	12.0	2.3	48.0	5.4	81.71	7.24	109.96	12.36
SIGAL	11.0	3.9	104.0	22.3	273.0	30.7	337.80	29.93	335.38	37.69
ATLANTIK	-	-	-	-	2.5	0.3	37.56	3.33	35.34	3.97
INTERSIG	-	-	-	-	1.0	0.1	8.84	0.78	32.36	3.64
Gjithsej	**283.0**	**100.0**	**472.0**	**100.0**	**888.5**	**100.0**	**1,128.65**	**100.00**	**889.75**	**100.00**

Grafik 11: Raporti i Sigurimit Vullnetar dhe Sigurimit të Detyrueshëm në shoqeritë e sigurimit.



5.4 Ndarja e tregut të sigurimeve sipas portofoleve të sigurimit

Tabele 17: Struktura e primeve sipas portofoleve në vite.

Portofolet	1999		2000		2001		2002		2003	
	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%	Prime	%
Sigurimet motorrike	1,523	82.5	1,599	79.3	2,177	73.4	2,778.72	73.05	2,998.20	79.84
Sigurimi i pasurise	263	14.2	296	14.7	539.4	18.2	633.83	16.67	543.86	14.48
Sigurimi i shendetit	57	3.1	113.5	5.6	75.1	2.5	106.19	2.79	126.91	3.38
Sigurimi i jetes	4	0.2	8.5	0.4	175	5.9	285.00	7.49	86.12	2.29
Gjithsej	**1,847**	**100**	**2,017**	**100**	**2,966.5**	**100**	**3,803.74**	**100**	**3,755.09**	**100**

5.4.1 Sigurimet motorrike

Në vitin 2003 të ardhurat e sigurimeve motorrike zunë 79.85 për qind të të ardhurave totale të aktivitetit sigurues, kundrejt 73.05 përqind që ishte në vitin 2002. Në vitin 2003 primet nga sigurimet motorrike rezultuan 7.90 për qind më shumë se në vitin 2002.
Peshën kryesore në të ardhurat e portofolit motorrik e zunë të ardhurat nga TPL
ë brëndshme e automjeteve dhe Kartoni jeshil.
Të ardhurat nga primet e sigurimit TPL në vitin 2003 zunë 68.37 për qind të të ardhurave të sigurimeve motorrike, nga 65.58 për qind në vitin 2002, ndërsa të ardhurat e siguruara nga kartoni jeshil zune 18.58 për qind të të ardhurave të portofolit te sigurmit motorrik, kundrejt 23.26 për qind të vitit 2002.

Nga shoqërite e sigurimit në vitin 2003 nga aktiviteti i TPL u arkëtuan 2,049 milionë lekë prime ose 227 milionë lekë më shumë se në vitin 2002, ku u arkëtuan 1,822 milionë lekë nga ky aktivitet .

Në rritjen e të ardhurave nga primet e sigurimit TPL së brëndshme ka ndikuar:

- numri ne rritje i automjeteve ;

kjo shprehet me rritjen e numrit te kontratave TPL, ku nga 149,999 kontrata të lidhura në vitin 2002, ne vitin 2003 numri i tyre rezultoi 165,272, pra rreth 15,273 kontrata më shumë se në vitin 2002.

Numri i mjeteve të transportit rrugor qe kanë marrë taksën e regjistrimit dhe qe kanë qarkulluar sipas DSHPTR per vitin 2003 eshtë rreth 168,000 mjete.

Sipas statistikave të marra nga shoqërite e sigurimit numri i kontratave është 146,959.

Të ardhurat nga Kartoni Jeshil në vitin 2003 rezultuan rreth 556.84 milionë lekë ose 89.38 milionë lekë me pak se në vitin 2002. Për sa i përket numrit te kontratave të Kartonit Jeshil në vitin 2002 u lidhën 35,276 kontrata,

Tabela 18: Volumi i primeve bruto te arketuara sipas klasave te Sigurimeve Motorrike gjate vitit 2003.

Klasat e sigurimit motorrik	Primet	
	(mln leke)	(mije USD)
KASKO	132.87	1,246.64
TPL	2,049.83	19,232.83
Kartoni jeshil	556.84	5,224.62
Kufitare	228.61	2,144.95
Provizore	30.05	281.95
Gjithsej	**2,998.20**	**28,130.99**

Grafik 12: Ndarja e tregut të sigurimit motorrik sipas portofoleve.



ndërsa në vitin 2003 u lidhën 35,965 kontrata ose 689 kontrata më shumë.

Të ardhurat nga primet e sigurimit Kufitar në vitin 2003 shënuan një rritje në krahasim me një vit me parë. Primet nga ky aktivitet u rritën në masën 44.33 milionë lekë ose rreth 24 për qind. Në qofte se në vitin 2002 u arketuan 184.27 milione lekë, në vitin 2003 u arkëtuan 228.60 milionë lekë. Numri i kontratave të sigurimit Kufitar në vitin 2003 rezultoi 57,538 ose 17,325 kontrata më shumë se në vitin 2002 ku ishin lidhur 40,213 kontrata për këtë lloj sigurimi të detyrueshëm.

Raporti dëme/prime për Sigurimin Motorrik në vitin 2003 rezultoi 39.91 për qind nga 28.25 për qind në vitin 2002.

Raporti dëme/prime për Sigurimin e Detyrueshëm në vitin 2003 rezultoi 38.23 për qind nga 26.59 për qind në vitin 2002.
Raporti dëme/prime për Portofolin e Kartonit Jeshil në vitin 2003 rezultoi 92.73 përqind nga 47.56 për qind në vitin 2002 dhe 41 përqind në vitin 2001:

Tregu shqiptar i sigurimeve për grupin e sigurimeve Motorrike në vitin 2003 u nda midis pesë shoqërive te sigurimit si më poshtë:



Tabela 19: Volumi i primeve të Sigurimit të Detyrueshëm TPL të arkëtuara në vitet 2000, 2001, 2002, 2003.

Shoqerite	2003			2002			2001			2000		
	Kontr	Prim	%	Kontr	Prim	%	Kontr	Prim	%	Kontr	Prim	%
INSIG	29,989	378.44	18.5	35,200	445.70	24.5	51,994	536.00	40.5	53,856	428	51.2
SIGMA	49,086	613.85	29.9	43,527	533.62	29.3	41,041	401.50	30.4	35,913	248	29.7
SIGAL	44,302	541.02	26.4	42,731	499.59	27.4	32,304	329.00	24.9	23,643	160	19.1
ATLANTIK	18,996	226.15	11.0	14,101	160.12	8.8	3,883	46.40	3.5	-	-	-
INTERSIG	22,899	290.38	14.2	14,440	183.29	10.1	661	8.70	0.7	-	-	-
Gjithsej	**165,272**	**2,049.8**	**100**	**149,999**	**1,822.32**	**100**	**129,883**	**1,321.6**	**100**	**113,412**	**836**	**100**

Tabela 20: Volumi i primeve të Sigurimit të Detyrueshem Kartoni Jeshil të arketuara në vite.

Shoqerite	2003			2002			2001			2000		
	Kontr	Prim	%	Kontr	Prim	%	Kontr	Prim	%	Kontr	Prim	%
